



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-022  
Prishtinë, më 9 mars 2018, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 9 MARS 2018

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Aida Dërguti, Kujtim Shala dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Glauk Konjufca, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Blerand Stavileci dhe Avni Bytyqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj, Musli Krasniqi dhe Osman Shatri.

**Nga NDI-ja:** Shefki Kastrati dhe

**Nga KDI-ja:** Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe katër (4) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Përgatitjet për seancë plenare
2. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

#### **1. Përgatitjet për seancën plenare të radhës**

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e përfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 8 e 9 shkurt dhe 1, 2 e 8 mars 2018, si dhe me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet formale për shqyrtim në seancë të re plenare.

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi gjatë javës së ardhshme t'i mbajë tri (3) seanca plenare, si në vijim.

**I. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 8 e 9 shkurt dhe 1 mars 2018 do të mbahet të martën, më 13 mars 2018, në orën 10:00, me këtë:**

### **Rend dite**

1. *Votimi i rekomandimeve të interpelancës lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 04/20 të datës 20.12.2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar, Vendimin nr. 05/24 i datës 12 janar 2018, për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarave që marrin paga nga Buxheti i Kosovës, si dhe Vendimi nr. 15/24 i datës 12 janar 2018 për lartësinë e pagesës mujore për familjet në Skemën e Ndihmave Sociale,*
2. *Debat parlamentar, sipas kërkesës së nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe gjashtë (6) deputetëve nënshkrues lidhur me raportin e 100 ditëve të punës të Qeverisë së Republikës të Kosovës,*
3. *Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Akreditimit,*
4. *Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016.*

**II.** Vazhdimi i seancës plenare, me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 2 mars 2018 dhe me pikën e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 8 mars 2018, do të mbahet të mërkurën, më 14 mars 2018, në orën 10:00, me këtë:

#### Rend dite

1. *Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) për mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica,*
2. *Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim, ADA,*
3. *Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA),*
4. *Votimi në parim i Projektligjit për miniera dhe minerale,*
5. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034,*
6. *Votimi në parim i Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës,*
7. *Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit,*
8. *Votimi në parim i Projektligjit për produkte të ndërtimit,*
9. *Votimi në parim i Projektligjit për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë,*
10. *Votimi në parim i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit,*
11. *Votimi në parim i Projektligjit për shërbimet postare,*
12. *Votimi në parim i Projektligjit për metrologji,*
13. *Votimi në parim i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare,*
14. *Votimi në parim i Projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut,*
15. *Votimi në parim i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe,*
16. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shoqëritë tregtare,*
17. *Përzgjedhja e një (1) kandidati për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,*
18. *Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e dy (2) anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,*
19. *Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,*
20. *Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa,*
21. *Votimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 07/21, datë 22.12.2017 në lidhje me Pallatin e Rinisë në Prishtinë,*
22. *Votimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të Jurisprudencës,*
23. *Debat parlamentar, sipas kërkesës të nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe pesë (5) deputetëve nënshkrues lidhur me takimin IV të përbashkët të Komisionit*

*Parlamentar të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, BE-Kosovë, të mbajtur më 17-19 janar 2018, në Strasburg (Francë),*

*24. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e deputetëve në komisionet parlamentare,*

*25. Formimi i Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari nga radhët e komunitetit shqiptar dhe dy (2) anëtarëve nga radhët e komuniteteve joshqiptare të Komisionit të Pavarur të Medieve dhe*

*26. Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me dhunën në familje dhe adresimin institucional.*

**III.** Seanca e re plenare do të mbahet të enjten, më 15 mars 2018, në orën 10:00, me këtë:

#### Rend dite

*1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*

*2. Koha për pyetje parlamentare,*

*3. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Astrit Dehari,*

*4. Shqyrtimi i Propozim-Programit të Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2018,*

*5. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores së Kuvendit,*

*6. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Autostradës Kijevë-Zahaq,*

*7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës,*

*8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214,*

*9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-014 për infrastrukturën kritike,*

*10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale,*

*11. Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015 dhe 2016,*

*12. Emërimi i dy (2) anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronave dhe*

*13. Emërimi i një (1) anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore.*

#### **2. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave**

*1. Procedimi i Projektligjit për amnistinë, i hartuar nga kryetari i GP të AAK-së, Ahmet Isufi, i mbështetur edhe nga 10 deputetë të tjerë*

Kryesia, pasi diktoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për amnistinë t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

*2. Procedimi i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i hartuar nga Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie*

Kryesia, pasi diktoi lidhur me procedimin e projektligjit të lartshënuar, nxori këtë

## P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, si komision funksional, që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

*3. Shqyrtimi i propozimit të deputetëve Mimoza Kusari dhe Dardan Sejdiu, të mbështetur edhe nga 13 deputetë tjerë nënshkrues, për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës*

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Sipas nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar, kryesuesi i Komisionit emërohet nga Kuvendi nga radhët e njërit grup parlamentar, i cili nuk është iniciator i Komisionit Hetimor dhe nuk i përket partisë së koalicionit qeverisës. Në këtë rast, iniciatorë janë deputetët e dy grupet parlamentare të opozitës (LVV dhe LDK).

Bazuar në kërkesën për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar nuk mund të propozohet kryesuesi i Komisionit, andaj kërkesa i kthehet propozuesit.

*4. Përfundimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin e organizatave të dala nga lufta e UÇK-së për seancë të jashtëzakonshme*

Kryesia, pasi e shqyrtoi përfundimin e lartshënuar, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

Përfundimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione në lidhje me peticionin për seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës u dërgohet organizatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

*5. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione për shtyrjen e datave për organizimin e Konferencës Rajonale*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione për shtyrjen e datave për mbajtjen e Konferencës Rajonale, me temë “Pozita e femrës në shoqëri - të arriturat dhe sfidat”, si dhe mbulimi i shpenzimeve për realizimin e kësaj konference, e cila është planifikuar të mbahet në Prishtinë, më 9-10 prill 2018.

*6. Shqyrtimi i kërkesës së GP të Listës serbe për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e orëve mësimore nga gjuha shqipe që do të mbahen për deputetët e këtij grupi*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

Grupit Parlamentar të Listës serbe i lejohen mjetet financiare në shumën 2 600 (dymijë e gjashtëqind) euro për pagesën e orëve mësimore nga gjuha shqipe, që mbahen për deputetët e këtij grupi parlamentar, sipas kërkesës me nr. 06/798/Do-483, datë 1. 3. 2018.

*7. Shqyrtimi i kërkesës së OJQ-së për persona të verbër dhe me shikim të dëmtuar “Drita Jonë - Vushtrri”, për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. OJQ-ja “Shoqata Drita Jonë-Vushtrri” mbështetet financiarisht në shumën prej 3183,96 euro për mbulimin e shpenzimeve lidhur me pjesëmarrjen e tyre në konferencën, e cila do të mbahet në Teksas (SHBA), prej 17-20 prill 2018.

2. Mjetet e parapara në pikën një (1) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfero, dhe transferohen në xhironlogarinë bankare të OJQ-së “Shoqata Drita Jonë-Vushtrri”, me numër 17-07-0016000607.95, në bankën NLB Prishtina.

*8. Raporti i delegacionit të Kuvendit lidhur me pjesëmarrjen e tij në takimet zyrtare në selinë qendrore të NATOS-s në Bruksel (Belgjikë), më 28-31 janar 2018*

Kryesia u njoftua me shkrim nga Delegacioni i Përhershëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s lidhur me pjesëmarrjen e tij në takimet zyrtare në Selinë e NATO-s, të mbajtura në Bruksel (Belgjikë), nga 28-31 janar 2018.

### **Pikat shtesë:**

*1. Kërkesa e organizatës joqeveritare “Qendra për promovimin e të drejtave të grave - QPDG” në Drenas për mbështetje financiare*

Kryesia e miraton kërkesën e OJQ-së së lartshënuar për mbështetje financiarisht, pas plotësimit të kriterëve që parashihen me Rregulloren nr. 05/Rr-002 për shpenzimin e buxhetit të Kuvendit nga kategoria subvencione dhe transfere, me ndryshimet dhe plotësimet e datës 19 dhjetor 2016.

*2. Shqyrtimi i kërkesës për aprovimin e pjesëmarrjes në aktivitetet e Asamblesë Parlamentare të NATO-s për vitin 2018*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Anëtarëve të Delegacionit të Përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe deputetit Slobodan Petroviq, si dhe zyrtarëve nga Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Merita Drenori dhe Arjana Musliu, u lejohet pjesëmarrja në aktivitetet e kësaj asambleje për vitin 2018 sipas kalendarit të takimeve për vitin 2018, të bashkangjitur.

*3. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Legjislacion për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kroaci*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Anëtarëve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Bilall Sherifi dhe Korab Sejdiu, u lejohet udhëtimi zyrtar në Kroaci, prej 25-27 mars 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, si dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*4. Shqyrtimi i kërkesës së zëvendëskryetarit të Komisionit për Integritet Evropian Armend Zemaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bullgari*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Zëvendëskryetarit të Komisionit për Integritet Evropian, Armend Zemaj, i lejohet udhëtimi zyrtar në Bullgari, prej 18-20 mars 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, si dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

**Shënim:** Kryetari konstatoi se të gjitha vendimet e lejuara për udhëtime jashtë vendit anulohen nëse Kuvendi mban seancë plenare.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Kadri VESELI**

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*